



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2 Nr.18 Tiranë,

Tel. 04 2268142; Fax 04 2268141

Nr.745 Prot.

Tiranë, më 13.12.2016

V E N D I M

Nr. 157, datë 13/12/2016

“Për përfundimin e procesit të verifikimit në lidhje me zbatimin e Vendimit Nr. 103, datë 26.09.2016, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil”

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; neneve 77-97, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe nenit 34 të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit dhe verifikimit të dokumentacionit të ardhur nga Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat me shkresën nr. 1471/1, datë 21.11.2016, “Kthim përgjigje”, në lidhje me zbatimin e Vendimit Nr. 103, datë 26.09.2016, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes, në lidhje me zbatimin e ligjit në procesin e administrimit të shërbimit civil, në institucionin Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat”, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

Vërej se:

Me Vendimin Nr. 139, datë 30.12.2015 “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në procesin e administrimit të shërbimit civil në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe institucionet e varësisë që janë pjesë e shërbimit civil”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka filluar mbikëqyrjen e përgjithshme, në lidhje me administrimin e shërbimit civil. Ky proces është përmbyllur me Vendimin Nr. 103, datë 26.09.2016, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes, në lidhje me zbatimin e ligjit në procesin e administrimit të shërbimit civil, në institucionin Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat”, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në të cilin është vendosur:

1. Të miratoj raportin përfundimtar të mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me administrimin e shërbimit civil në institucionin, Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, i cili do të jetë pjesë e këtij vendimi.

2. Institucioni i mbikëqyrur t'i kërkojë Departamentit të Administratës Publike, që të japë zyrtarisht konfirmimin e tij, lidhur me përshkrimet e punës, nëse ato janë të hartuara në bazë dhe në përputhje me legjislacionin specifik të fushës apo formatin standard të miratuar, siç parashikohet në pikën 19, të Vendimit Nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*, i ndryshuar.

Pas marrjes së konfirmimit nga njësia përgjegjëse, përshkrimet e punës t'i dërgohen Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme, për të vijuar procesin me nënshkrimin e tyre në ndarjen përkatëse, siç parashikohet në pikën 18, shkronja “c”, të Vendimit Nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*, i ndryshuar.

Një kopje e përshkrimeve të punës të nënshkuara të bëhen pjesë e dosjes së personelit të çdo nëpunësi civil, një kopje të depozitohet në arkivin e institucionit dhe një kopje të depozitohet pranë Departamentit të Administratës Publike.

3. Për nëpunësin në periudhë prove *****, eprori direkt, të caktojë nëpunësin më të vjetër, nën kujdesin e të cilit do të vendoset nëpunësi civil në periudhë prove. Në përfundim të periudhës së provës, mendimi me shkrim i nëpunësit më të vjetër duhet të bëhet pjesë e procedurës së konfirmimit të nëpunësit civil.
4. Departamenti i Administratës Publike, me cilësinë e njësisë përgjegjëse, duhet të drejtojë procesin e rregullimit të ligjshmërisë, për pozicionin *“Shefi Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe IT”*, në njësinë e Shërbimeve Mbështetëse, në institucionin Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, duke respektuar procedurën e plotësimit të tij, sipas rregullave të përcaktuara në ligjin nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar.
5. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **60** ditë nga marrja dijani për këtë vendim. Njësia përgjegjëse, duhet të zbatojë këtë vendim duke u bazuar në konkluzionet e paraqitura në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.

Me kalimin e afatit procedural të lënë për zbatimin e rekomandimeve të vendimit të mësipërm, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me shkresën nr. 960/16 prot., datë 26.09.2016, *“Në lidhje me zbatimin e Vendimit Nr. 103, datë 26.09.2016, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil”*, ka kërkuar nga institucioni informacion në lidhje me masat që janë marrë për zbatimin e këtij vendimi, dhe vënien në dispozicion të të gjithë praktikës shkresore që materializon zbatimin e tij, brenda një afati 10-ditor nga marrja dijani.

Në përgjigje të shkresës së mësipërme, Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, me shkresën nr. 1471/1 prot., datë 21.11.2016, *“Kthim përgjigje”*, ka vënë në dijeni Komisionerin mbi masat e marra në zbatim të këtij vendimi.

Pas verifikimit të dokumentacionit shkresor të administruar nga ana e Komisionerit të Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil, rezultoi se:

- Në lidhje me zbatimin e pikës 2, të vendimit dhe të rekomandimeve të Komisionerit në Raportin Përfundimtar të Mbikëqyrjes, njësia përgjegjëse ka ndërmarrë këto veprime:

Me shkresën nr. 1644/3 prot., datë 06.12.2016, *“Kërkim konfirmimi mbi rregullsinë e Përshkrimeve të Punës”*, institucioni i ka dërguar Departamentit të Administratës Publike kopje të përshkrimeve të punës dhe i ka kërkuar konfirmim nëse ato janë hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Me shkresën nr. 1644/1 prot., datë 09.11.2016 *“Në lidhje me konfirmimin e përshkrimeve të punës”*, Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, i është drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme, duke i kërkuar nënshkrimin e formularëve të përshkrimit të punës sipas dispozitave ligjore të cilat rregullojnë këtë institut, në përputhje me rekomandimet e Komisionerit.

- Në lidhje me zbatimin e pikës 3, me shkresën nr. extra prot., datë 03.08.2016, *“Mendim mbi performancën në punë, gjatë periudhës së provës”*, është dhënë mendimi me shkrim i nëpunësit më të vjetër për nëpunësin civil në periudhë prove *****. Më tej, me shkresën nr. 4857/3 prot., datë 09.11.2016, Departamenti i Administratës Publike ka nxjerrë aktin e deklaramit të statusit të nëpunësit *****, në përfundim të periudhës së provës, si nëpunës civil në pozicionin Specialist (Jurist/ Menaxhimi i Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve), në Sektorin e Burimeve Njerëzore dhe IT-së, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse.

- Në lidhje me zbatimin e pikës 4, të vendimit të Komisionerit, Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse ka drejtuar procesin e rregullimit të ligjshmërisë si më poshtë:

Me shkresën nr. 5069 prot., datë 19.08.2016, *“Emërim”*, është emëruar Përgjegjësi i Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe IT, në përputhje me rregullat e përcaktuara nga ligji nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe Kreun III, të Vendimit Nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, *“Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”*.

Sa më sipër, bazuar në dokumentacionin e administruar, u verifikua reagimi i njësisë përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në përmbajtjen e raportit të mbikëqyrjes dhe përfundimisht, arrij në konkluzionin se Vendimi Nr. 103, datë 26.09.2016, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes, në lidhje me zbatimin e ligjit në procesin e administrimit të shërbimit civil, në institucionin Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat”*, është zbatuar plotësisht, nga ana e subjektit.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe në nenin 34 të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit për zbatimin e Vendimit Nr. 103, datë 26.09.2016, në institucionin Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësisë përgjegjëse, duke zbatuar plotësisht rekomandimet e Vendimit Nr. 103, datë 26.09.2016, , “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes, në lidhje me zbatimin e ligjit në procesin e administrimit të shërbimit civil, në institucionin Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat”.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni, Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Departamenti i Administratës Publike dhe Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA